# Lista e Cmimeve të Aksesit në Tubacione

ONE Albania  Sh.a.

JANAR 2023

Versioni 1.1
(Ref. VKD Nr.14, datë 07.11.2022)
(Ref. VKD Nr. 2702 dhe 2704, datë 22.12.2016)

Bazuar në vendimin e AKEP nr.14, datw 07.11.2022 "*Për miratimin e transferimit të të drejtave të përdorimit të frekuencave të dhëna sipas regjimit të Autorizimit Individual dhe regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm si dhe për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara në aktet rregullatore të nxjerra nga AKEP nga sipërmarrësi ALBtelecom sh.a te sipërmarrësi One Telecommunications sh.a*"; si dhe,

Bazuar në vendimet e AKEP Nr. 2702 dhe Nr 2704, date 22.12.2016, ONE Albania publikon cmimet për përdorimin e hapësirës së lirë të infrastrukturës së tubave.

Cmimet per akses ne tubacione, janë te lidhura me kabllot te ndarë në tre kategori:

C1. Kabëll me diametër deri në 10+0.5mm

C2. Kabëll me diametër >10+0.5mm deri nnë 20+0.5mm

C3. Kabëll me diametër >20+0.5mm deri në 30+0.5mm

## Tarifat e aksesit në tubacione të ONE Albania:

| | | | **Tarife fillestare (Lek/km)** | **Tarifat mujore ( ne lek/km) per akses ne tuba ne nivel local/urban** | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Distanca (Km) | Diametri (mm) | deri ne 10 mm +0.5 | > 10-20 mm+0.5 | 20-30 mm+0.5 |
| **T0 (segment ≤0.2)** | **D1** | < 0.2 | 13,832 | 11,066 | 12,449 | 13,832 |
| **T1 Distanca 0.2-20 km** | **D2** | 0.2-5 | 11,066 | 8,299 | 10,097 | 12,449 |
| | **D3** | 5-20 | 11,066 | 7,608 | 9,406 | 11,757 |
| **T2 Distanca 20-80 km** | **D4** | 20-40 | 11,066 | 7,193 | 8,852 | 11,066 |
| | **D5** | 40-80 | 11,066 | 6,639 | 8,299 | 9,959 |
| **T3 Distanca 80-300 km** | **D6** | 80-160 | 11,066 | 6,086 | 7,746 | 9,406 |
| | **D7** | 160-300 | 11,066 | 5,533 | 6,916 | 8,299 |
| **T4 > 300 km** | **D8** | > 300 | 11,066 | 4,980 | 6,363 | 7,193 |

*Shënim: Tarifat janë pa TVSH*

Operatori mund të zgjedhë një ose të gjitha kategoritë e kabllove në varësi të nevojave dhe faturimi do të bëhet në bazë të distancës dhe cmimit për secilën kategori.

Gjatësia minimale e segmentit individual do të jetë 0.2 km. Segmentet individuale nuk do të llogariten për aq kohë sa nuk do të zgjaten më shumë se kjo distancë. Cmimi mujor për segmente më pak se 0.2 km nuk do të varet nga distanca dhe do të jetë i njëjtë me cmimin e segmentit të barabartë me 0.2 km:

- 11 066 Lekë për C1
- 12 449 Lekë për C2

- 13 832 Lekë për C3, dhe
- 13 832 Lekë tarifë fillestare për koston e instalimit për segment.

Pagesat do të jenë mujore. Kohëzgjatja minimale e kontratës do të jetë 3 vjet.

Hyrja në pusetë do të behet duke zbatuar rigorozisht specifikimet teknike të ONE Albania.

Në diagramin e mëposhtëm janë përshkruar segmentet individuale:




Të gjitha segmentet e mësipërme janë kërkuar në kohë të ndryshme.

*Segmenti 1* është më i madh e do të konsiderohet në T1 ose në grupe tarifore dhe më të lartë.

*Segmentet 2* janë më të shkurtra se 0.2 km por janë zgjatje e segmentit 1, në këtë mënyrë do të konsiderohen si shtesë të grupit tarifor T1 ose më të lartë.

*Segmenti 3* është më shumë se 0.2 km kështu që do të konsiderohet si shtesë të grupit tarifor T1 ose më të lartë.

*Segmentet 4* janë segmente individuale dhe <0.2km, në këtë mënyrë ata do të konsiderohen si grup tarifor T0.

Këto cmime aplikohen nga nga 01 Korrik 2017.